- Со оглед дека работната група формирана од министерот за правда за измена на Кривичниот законик, паралелно работи и на изготвување комплетно нов Кривичен законик, се препорачува доставување предлози за нови кривични дела што се однесуваат на заштитата на новинарите и медиумските работници по примерите на други држави.
- Да се спроведат обуки во духот на Акцискиот план на ОН за безбедноста на новинарите и прашањето на неказнивост²⁹ за органите за прогонот, судските и другите државни службеници одговорни за исполнување на обврските на државата за заштита на новинарите и другите медиумски работници.
- Да се обезбеди редовна обука за судии, обвинители, адвокати³⁰ и органите за прогон, за нивните обврски според хуманитарното и меѓународното право за човековите права, важната улога на новинарите и другите медиумски работници во едно демократско општество, спецификите во истражувањето напади врз новинари и разгледувањето на тие предмети од страна на судовите, посебните потреби за заштита на новинарите и другите медиумски работници, вклучително и родово специфични прашања.
- Се препорачува да се вклучуваат новинарски и организации за човекови права во изготвувањето на програмите за обука и реализацијата на обуките за судии, обвинители, адвокати и органите за прогон.
- Со оглед на спецификата во постапувањето со кривичните пријави за напади на новинари и медиумски работници, која е тесно поврзана и со кривичните дела за насилство врз жените во кои спаѓаат и жените новинарки и медиумски работници, а во насока на имплементација на Истанбулската конвенција, се

29 UN Plan of Action on the Safety of Journalists and the Issue of Impunity (unesco.org) <https://en.unesco.org/un-plan-action-safety-journalists> пристапено на 12 декември 2021 година

30 Предлог-закон за изменување и дополнување на законот за адвокатурата, предвидува воведување континуирана обука за адвокатите, организирана од страна на Адвокатската комора со законски утврден фонд на часови на годишно ниво, како и сеопфатна анализа на постојната законска поставеност и работа на адвокатската професија и пристапување кон нејзина реформа согласно со реформите во другите сегменти од правосудниот сектор, пристапено на 12 декември 2021 година https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=66638

препорачува, во зависност од обемот на работа на обвинителството, да се назначат еден или повеќе јавни обвинители што ќе постапуваат по овој вид предмети³¹. Назначувањето конкретен обвинител подразбира натамошна специјализација на обвинителот за пријави за напади на новинари и медиумски работници, која е тесно поврзана и со кривичните дела за насилство врз жените во кои спаѓаат и жените новинарки и медиумски работници³².

- Се препорачува да се детектираат слабостите при приемот на пријави за напади на новинари и други медиумски работници и да се подготви упатство за вработените во полицијата и во МВР за унифицирано постапување со овој вид пријави.
- Се препорачува надлежните органи, обучените лица да ги постават на соодветни позиции во органот во кој работат со цел да ги имплементираат законите согласно спроведените обуки. Оваа препорака се однесува на МВР, каде што честите прераспоредувања имаат негативен ефект на целокупното работење бидејќи обучените службени лица се распоредуваат на други работни позиции на кои нема да можат да го применат знаењето стекнато со обуката.
- Поради зголемениот интерес на меѓународната заедница за безбедноста на новинарите и медиумските работници, како и заради зголемување на довербата во државните органи и постигнување повисок степен на транспарентност кон јавноста, се препорачува во МВР и во јавните обвинителства да се воведат ефикасен систем за евиденција на пријавените случаи за напади врз новинарите.
- Се препорачува судовите да го надградат АКМИС системот со решение, кое ќе овозможи посебно да се внесат кривичните и прекршочните постапки во кои е нападат новинар и медиумски работник во вршење на своите активности.

31 Пример, во ОЈО Скопје, во текот на 2013 и на 2014 година, јавните обвинители беа поделени по групи и тоа: имотни деликти, кривични дела од областа на сообраќајот, кривични дела против животот и телото и кривични дела поврзани со даночното затајување.

32 Recommendation CM/Rec(2016)4 of the Committee of Ministers to member States on the protection of journalism and safety of journalists and other media actors, Guidelines, Prosecution, General requirements, 20.“ Истрагите треба да се спроведуваат од специјализирани, наменски единици од релевантни државни власти каде што на службениците им е овозможена соодветна обука во областа на меѓународните норми и заштитни механизми за човековите права“. https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?Objec-tid=09000016806415d9#_ftn1

БИБЛИОГРАФИЈА

Водич за спроведување за одбрани теми од столбовите Заштита и Гонење од Насоките за Препораката CM/Rec(2016)4 за заштита на новинарството и безбедноста на новинарите и другите медиумски работници DGI(2020)11, Совет на Европа, јуни 2020

Годишниот извештај на партнерските организации на Советот на Европа за Промовирање и заштита на новинарството и безбедноста на новинарите, Совет на Европа, април 2021 година

Милан Спировски, Верче Тодоровска-Костовска, Показатели за степенот на слобода на медиумите и за безбедноста на новинарите во 2020, Здружение на новинарите на Македонија, Скопје, 2020, стр.26

Горан Ризаов, Призма, 24 декември 2014 година <https://prizma.mk/dve-godini-po-tsрни-ot-ponedelnik/>

Selmani and others v. The Former Yugoslav Republic of Macedonia – Judgment <https://bi-roescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/СЕЛМАНИ-И-ДРУГИ-ПРОТИВ-РЕПУБЛИКА-МАКЕДОНИЈА-Пресуда.pdf>

Опсерваторија на македонски реформи, 02 јуни 2020 година, пристапено на 15 декември 2021, <https://mediaobservatorium.mk/novinari-ja-tuzhat-drzhavata-shto-ne-gi-kazni-nasil-nitsite-od-27-april/>

Здружението на новинарите на Македонија – ЗНМ, соопштение од 11 декември 2020 година, пристапено на 15 декември 2021 година <https://mk.tv21.tv/znm-novinari-od-27-mi-april-po-vtor-pat-zhrtvi-ovoj-pat-od-sudot/>

Основен кривичен суд Скопје, пристапено на 8 декември 2021 година, <https://bit.ly/3pp2I53>

Случаи на повреда на правата на новинарите 2021, пристапено на 8 декември 2021, <https://znm.org.mk/povreda-na-novinari/>

Recommendation CM/Rec (2016)4, Committee of Ministers to member States on the protection of journalism and safety of journalist and other media actors, 13 April 2016

Костадин Богданов, Иван Брешковски, Драган Секуловски, Подобрување на безбедноста на новинарите – преку измена на Кривичниот законик – Анализа на меѓународни стандарди и домашна регулатива, Скопје 2020 година

Анализа и препораки за измена на Кривичниот законик на Република Македонија за зголемена заштита на новинарските екипи при вршењето на нивната професионална должност, Самостоен синдикат на новинари и медиумски работници, пристапено на ден 8 декември 2021 година <https://ssnm.org.mk/wp-content/uploads/2017/11/Анализа-и-препораки-за-КЗ-FINAL.pdf>

Собрание на РСМ, предлог-закон за измена и дополнување на Кривичниот законик, пристапено на ден 8 декември 2021 година, <https://bit.ly/3erOIRY>

COE, Rec. No. R (2000) 7, Committee of Ministers To Member States on the Right of Journalists not to Disclose Their Sources of Information (adopted 08 March 2000) <https://rm.coe.int/16805e2fd2>

Christof Heyns and Sharath Srinivasan, Protecting the Right to Life of Journalists: The Need

for a Higher Level of Engagement, Human Rights Quarterly, May 2013, The Johns Hopkins University Press

Republika Hrvatska, Ministarstvo pravosuđa i uprave, Kazneni zakon, procisceni tekst, пристапено на ден 11 декември 2021 година <https://mpu.gov.hr/pristup-informacija-ma-6341/zakoni-i-ostali-propisi/zakoni-i-propisi-6354/kazneno-pravo/6441>

Кривичен закон на Русија 13.6.1996. N 63-ФЗ, пристапено на ден 11 декември 2021 http://www.consultant.ru/document/cons_doc_LAW_10699/#p2075

Костадин Богданов, Иван Брешковски, Драган Секуловски, Подобрување на безбедноста на новинарите – преку измена на Кривичниот законик – Анализа на меѓународни стандарди и домашна регулатива, Скопје 2020 година страна 28-29

GenderIT.org, New challenges to freedom of expression: countering online abuse of female journalists, пристапено на 11.декември 2021 година <https://www.genderit.org/es/node/4705>

New challenges to freedom of expression: countering online abuse of female journalists, стр.41, пристапено на 11.декември 2021 година <https://www.genderit.org/es/node/4705>

IFJ global survey shows massive impact of online abuse on women journalists - IFJ <https://www.ifj.org/media-centre/news/detail/article/ifj-global-survey-shows-massive-impact-of-online-abuse-on-women-journalists.html> пристапено на 11 декември 2021 година

OSCE, The Representative on Freedom of the media, Dunja Mijatovic, Communiqué on the growing safety threat to female journalists online, 02/201, стр. 44 <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/411206>

Истанбулска конвенција, <https://rm.coe.int/168008482e> пристапено на 11 декември 2021 година

Д-р Јасмина Димитриева, Значајни пресуди на ЕСЧП со коментар: Говор на омраза и кривични дела од омраза, ОБСЕ декември 2016, стр.10

Özgür Gündem v. Turkey, no. 23144/93, §§ 42-43, ECHR 2000-III.

Gongadze v. Ukraine, no. 34056/02, ECHR 2005-XI.

UN Plan of Action on the Safety of Journalists and the Issue of Impunity (unesco.org) <https://en.unesco.org/un-plan-action-safety-journalists> пристапено на 12 декември 2021 година

Предлог-закон за изменување и дополнување на законот за адвокатурата, предвидува воведување континуирана обука за адвокатите, организирана од страна на Адвокатската комора со законски утврден фонд на часови на годишно ниво, како и сеопфатна анализа на постојната законска поставеност и работа на адвокатската професија и пристапување кон нејзина реформа согласно со реформите во другите сегменти од правосудниот сектор, пристапено на 12 декември 2021 година, https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=66638

Recommendation CM/Rec(2016)4 of the Committee of Ministers to member States on the protection of journalism and safety of journalists and other media actors, Guidelines, Prosecution, General requirements, 20.“ Истрагите треба да се спроведуваат од специјализирани, наменски единици од релевантни државни власти каде што на службениците им е овозможена соодветна обука во областа на меѓународните норми и заштитни механизми за човековите права“. https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016806415d9#_ftn1

DOKUMENT PËR POLITIKA

**ZBRAZËTIRAT KYÇE SISTEMORE DHE ZGJIDHJET
E MUNDSHME PËR PËRMIRËSIMIN E AMBIENTIT
NË SHOQËRI NË ASPEKT TË SIGURISË SË
GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK**

Autori: Olja Ristova

Shkupi

Janar 2022



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Titull: Zbrazëtirat kyçe sistemore dhe zgjidhjet e mundshme për përmirësimin e ambientit në shoqëri në aspekt të sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik - Dokument për politika

Autori: Olja Ristova

Botues: Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Projekt: Punonjës të sigurt mediatik për gazetari kualitative në Maqedoni

Përktheu në shqip: Ferikan Iljazi

Shtyp: Grafotroid doo Skopje

Tirazhi: 150

Ky botim është përgatitur me ndihmën financiare të Balkan Trust for Democracy, një projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Ambasadës Mbretërore Norvegjeze në Beograd. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyrojnë pikëpamjet e Ambasadës Mbretërore Norvegjeze në Beograd, Fondit Ballkanik për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij.



PËRMBAJTJA

Hyrje.....	30
1. Siguria e gazetarëve në Maqedoninë e Veriut.....	32
2. Përmbledhje statistikore.....	34
3. Korniza ligjore për siguri të gazetarëve dhe punonjësve mediatik.....	40
4. Shembuj për praktika të mira në shtetet e tjera.....	43
5. Specifika gjinore gjatë sulmeve online.....	44
6. Verdikte të GJEDNJ.....	45
Rekomandime.....	46
Bibliografia.....	48

Sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve të tjerë mediatik janë një shkelje tejet e rëndë e të drejtave të njeriut pasi që nuk janë të drejtuara vetëm ndaj individëve, por i privojnë edhe të tjerët nga e drejta e tyre për të marrë informacione, dhe kështu kufizohet diskutimi publik i cili është bërthamë e një demokracie pluraliste¹. Liria e mediave është një element integral i sigurisë dhe prosperitetit global. Qytetarët kanë nevojë për media të lira të cilat do të raportojnë në mënyrë të lirë dhe me informacione të vërteta.

Në shtetet ku ka media të lira, shoqëria karakterizohet si më prosperitare. Shumë shpesh problemi qëndron tek politikat qeveritare dhe korniza ligjore e cila nuk është e mjaftueshme apo është restriktive prandaj edhe gazetarët dhe punonjësit mediatik nuk ndjehen të sigurt gjatë ushtrimit të profesionit të tyre.

Dhuna ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik gjatë dekadës së fundit është vazhdimisht në rritje. Sipas raportit vjetor të Këshillit të Evropës nga viti 2021, që ka të bëjë me Promovimin dhe mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve², në vitin 2020, gjatë periudhës së pandemisë në Evropë, janë regjistruar më shumë se 200 sulme ndaj gazetarëve, dhe këto sulme kanë një ndikim serioz ndaj pavarësisë së gazetarisë. Gjysma e sulmeve janë format më të rënda dhe më të dëmshme të shkeljeve të lirisë së mediave si vrasje, kërcënime serioze ndaj jetës dhe sulme fizike. Shumica e sulmeve nuk janë hetuar siç duhet nga ana e institucioneve dhe organeve kompetente, prandaj për këtë arsye autorët ngelen të pa ndëshkuar, ndërsa një pjesë e gazetarëve për shkak të mosbesimit në institucione nuk i denoncojnë.

Sipas regjistrimit të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, në periudhën prej vitit 2018 deri në vitin 2020 në Maqedoninë e Veriut janë regjistruar gjithsej 21 sulme ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik³ që përfshijnë kërcënime fizike, kërcënime verbale, keqtrajtme, kërcënime me jetë si dhe kërcënime ndaj mediave dhe organizatave mediatike. Gjatë vitit të fundit është rritur edhe numri i sulmeve verbale dhe sulmeve online.

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të analizohet se a ka një kornizë të qartë ligjore me të cilën do të kriminalizohet dhuna ndaj gazetarëve, sa dhe çfarë formash të mbrojtjes ofron legjislativi aktual, a veprojnë në mënyrë efikase të gjitha organet kompetente, a funksionojnë mekanizmat e parapara ligjore për mbrojtje, dhe a i

- 1 Udhërrëfyes për zbatimin e temave të zgjedhura nga themelet Mbrojtje dhe Përndjekje nga Udhëzimet për Rekomandimin CM/Rec(2016)4 për mbrojtje të gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve të tjerë mediatik DGI(2020)11, Këshilli i Evropës, qershor 2020
- 2 Raporti vjetor i organizatave partnere të Këshillit të Evropës për Promovimin dhe mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve, Këshilli i Evropës, prill 2021.
- 3 Millan Spirovski, Verçe Todorovska - Kostovska, tregues për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve në vitin 2020, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, Shkup, 2020, faq 26.

implementojnë policia, prokuroria dhe gjykataligjet për preventivë dhe mbrojtje të të drejtës për jetë, integritetit fizik dhe moral, lirisë së shprehjes dhe të drejtave të saj simotra.

Përgatitja e këtij dokumenti u zbatua duke bërë analizë juridike të legjislativit vendor që është relevant për mbrojtje të integritetit moral dhe fizik të gazetarëve dhe punonjësve të tjerë mediatik, analizë të harmonizimit të legjislativit vendor me standardet ndërkombëtare të kësaj fushe, me theks të veçantë tek standardet për mbrojtje të gazetareve femra dhe aktoreve të tjera mediatike – femra, nga kërcënimet gjatë punës së tyre të bazuara në gjini.

Është bërë analizë e të dhënave të marra nëpërmjet kërkesës për qasje deri tek informacionet me karakter publik nga Ministria e Brendshme e Maqedonisë së Veriut, gjykatat dhe prokuroritë themelore, si dhe analizës së të dhënave relevante që janë publikuar nga institucionet qeveritare dhe organizatat civile, për reagim të organeve gjyqësore pas rasteve të denoncuara të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve të tjerë mediatik deri tek organet kompetente.

1 SIGURIA E GAZETARËVE NË MAQEDONINË E VERIUT

Karakteristike për sulmet ndaj gazetarëve në Maqedoninë e Veriut sikurse në vendet tjera, e posaçërisht ato evropiane, është se nuk veprohet me nivelin e duhur të seriozitetit nga ana organeve kompetente shtetërore. Një numër shumë i vogël rastesh⁴ marrin epilog gjyqësor, ndërsa pjesa më e madhe e rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve përfundojnë me denoncimin në MPB apo në Prokuroritë Themelore, pa u përcjellë deri në gjykatë apo refuzohen.

Rastet që mbështesin tezën e mosndëshkimit të autorëve të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, të rëndësishme për Maqedoninë e Veriut ndër vite janë këto:

- Më 24.12.2012, në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut ku po diskutohej për propozim-buxhetin e vitit 2013, sigurimi i Kuvendit hyri në galerinë e gazetarëve ku ishin vendosur gazetarët dhe punonjësit e tjerë mediatik, një pjesë të tyre e dëboi duke përdorur forcë, teksa në mesin e tyre ishte edhe ish kryetari i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, Naser Selmani. Shoqata e Gazetarëvedorëzoi parashtresë deri tek Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë për shkelje të nenit 16 të Kushtetutës, por gjykata vendosi se nuk ka shkelje të këtij neni me të cilin garantohet se censura është e ndaluar, dhe garantohet qasja deri tek informacionet⁵. Është iniciuar procedurë para Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, Selmani dhe të tjerët kundër Republikës së Maqedonisë, pas çka gjykata ka sjellë vendim me të cilin ka konstatuar shkelje të nenit 6 dhe nenit 10 nga GJEDNJ dhe e ka obliguar shtetin që tu paguajë gazetarëve që u ankuan nga 5 000 euro⁶.
- Gazetari Tomisllav Kezharovski ishte dënuar për tekst të publikuar në nëntor të vitit 2008 në gazetën e atëhershme “Reporter 92”, që është një rast karakteristik për dënim të një gazetari me burg gjatë ushtrimit të punës së tij.
- Ngjarjet e 27 prillit të vitit 2017 janë një provë për pozitën dhe trajtimin e gazetarëve në Maqedoninë e Veriut. Pas hyrjes me dhunë të pjesëtarëve të iniciativës qytetare “Për Maqedoni të Përbashkët” në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ishin sulmuar fizikisht edhe gazetarë dhe punonjës mediatik. Në fund të prillit të vitit 2020, tre gazetarë – Natasha Stojanovska, Dushica Mërgja dhe Goran Tërpenovski, që ishin viktimat e hyrjes me dhunë në Parlament më 27 prill të vitit 2017, dorëzuan padi ndaj shtetit për shkak të cenimit të së drejtës për liri

4 Shembull, sipas tabelës 1 me të dhëna nga MPB, në vitin 2020 ishin dorëzuar 10 denoncime ku si të dëmtuar paraqiten gazetarë, ndërsa sipas tabelës me të dhëna nr 3 që ka të dhëna nga Gjykata Themelore Penale në Shkup, më vitin 2020 ka vetëm një rast të proceduar në gjykatë.

5 Goran Rizaov, Prizma, 24 dhjetor 2014 <https://prizma.mk/dve-godini-po-tsriot-ponedelnik/>

6 Selmani and others v. The Former Yugoslav Republic of Macedonia – Judgment <https://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/СЕЛМАНИ-И-ДРУГИ-ПРОТИВ-РЕПУБЛИКА-МАКЕДОНИЈА-Пресуда.pdf>

të shprehjes dhe për kompensim të dëmit jo-material⁷. Pas sjelljes së vendimit të shkallës së parë u deklarua edhe SHGM e cila e vlerësoi verdiktin e gjykatës për ngjarjet e 27 prillit si të turpshëm dhe në dëm të gazetarëve dhe lirisë së shprehjes në vendin tonë, dhe paralajmëroi se për këtë verdikt do t'i njoftojë të gjithë organizatat relevante ndërkombëtare⁸.

- Rast karakteristik janë edhe kërcënimet verbale të drejtuara ndaj gazetares së AION Meri Jordanovska dhe redaktores së televizionit Alfa Iskra Koroveshovska, nga i njëjti autor, që është ndër rastet e rralla që kanë marrë epilog gjyqësor me vendim të plotfuqishëm gjyqësor.
- Gjatë vitit 2020 janë regjistruar dy raste të kërcënimit me jetë ndaj gazetarit Gorazd Çomovski të Tv24 dhe gazetares Almedina Ismajli nga Tv21 për çka nuk ka një epilog gjyqësor.
- Në vitin 2020 është rritur numri i kërcënimeve dhe sulmeve online ndaj gazetarëve femra, janë regjistruar sulme ndaj Tanja Milevskas nga MIA dhe Miroslava Burns nga Sloboden Peçat.

Në statistikat e organeve shtetërore dhe organizatave civile, nuk janë vërejtur raste të vrasjes së ndonjë gazetari. Edhe pse nuk ka rast të tillë, megjithatë duhet të ndërmerren masa për preventivë dhe mbrojtje nga sulmet ndaj gazetarëve që do të rezultojë me zbulimin e autorëve, hetimin rrënjësor nga organet e përndjekjes dhe procedura gjyqësore. Kjo posaçërisht duhet të merret parasysh pasi gjithnjë para vrasjeve të gazetarëve ka pasur kërcënime ndaj tyre, dhe për këtë shkak organet shtetërore, policia dhe prokuroria duhet që t'i marrin shumë seriozisht kërcënimet ndaj gazetarëve, të mbajnë evidencë dhe të veprojnë pas denoncimeve. Në këtë drejtim duhet të kihet parasysh edhe se kërcënimet e ndryshojnë formën. Para përdorimit masiv të internetit, kërcënimet janë manifestuar me përballje në rrugica të errëta, në telefon, me sulme fizike, ndërsa tani me përdorimin masiv të rrjeteve sociale, kërcënimet janë kryesisht online prandaj edhe organet shtetërore duhet të kenë një qasje serioze ndaj këtyre denoncimeve.

7 Observatoriumi i reformave maqedonase, 02 qershor 2020, qasur më 15 dhjetor 2021, <https://mediaobservatorium.mk/novinari-ja-tuzhat-drzhavata-shto-ne-gi-kazni-nasilnitsite-od-27-april/>

8 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë - SHGM, kumtesë nga 11 dhjetori 2020, qasur më 15 dhjetor 2021 <https://mk.tv21.tv/znm-novinari-od-27-mi-april-po-vtor-pat-zhrtvi-ovoj-pat-od-sudot/>

2 PËRMBLEDHJE STATISTIKORE

Për nevojat e kësaj analize ishin dërguar kërkesa për qasje deri tek informatat me karakter publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, deri tek të gjithë prokuroritë themelore dhe të gjithë gjykatat themelore në Maqedoninë e Veriut. Në kuadër të kërkesave ishin vendosur pyetjet si vijon: Sa denoncime/kallëzime penale për sulm ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik janë dorëzuar deri tek MPB apo deri te Prokuroria Themelore, sa akuza janë ngritur në gjykatë apo sa procedura janë zhvilluar gjatë periudhës prej vitit 2019 deri 2020, dhe prej 1 janarit 2021 deri 30 tetor të vitit 2021 ; për cilat vepra penale ka pasur denoncime ndaj autorëve, a janë dorëzuar kallëzime/akuza dhe a janë zhvilluar procedura për vepra të kryera penale si: Vrasje nga neni 123, Lëndim trupor nga neni 130, Lëndim i rëndë trupor nga neni 131, Detyrim nga neni 139, Privim i paligjshëm nga liria sipas nenit 140, Kërcënim i sigurisë sipas nenit 144, apo për ndonjë vepër tjetër penale të paraparë në Kodin Penal në të cilin viktimat – i dëmtuari është gazetar apo punonjës mediatik ; a janë dorëzuar kallëzime/akuza penale nga Sektori për kriminalitet kompjuterik pranë MPB-së, apo nga Prokuroria për kërcënime të bëra nëpërmjet sistemit informatik ndaj gazetarëve apo punonjësve mediatik në pajtueshmëri me nenin 144, alinea 4 nga KP – Kërcënim i sigurisë, sa prej denoncuesve të kallëzimeve penale apo viktimave, janë gazetarë apo punonjës mediatik femra ; sa prej këtyre denoncimeve janë proceduar deri tek Prokuroritë Themelore apo Prokuroria Themelore Publike ; a ekziston repart i veçantë apo inspektorë/prokurorë/gjykatës që janë të trajnuar apo specializuar që të veprojnë për vepra penale të kryera ndaj gazetarëve apo punonjësve mediatik.

Të dhënat nga të gjitha përgjigjet janë vendosur në një tabelë Excel, ndërsa në tre tabela të tjera të posaçme janë vendosur të dhënat nga MPB, prokuroritë themelore dhe gjykatat të cilat janë relevante për këtë analizë.

Tabela 1: Përgjigje e MPB-së pas kërkesës për qasje deri tek informacionet me karakter publik

Viti	2018	2019	2020	2021
Numri denoncimeve	10	15	10	8
Paralajmërim	3	7	3	
Njoftim PTHP	4	1	1	1
Kallëzim penal deri tek PTHP			3	3
Kundërvajtje	2	2	2	1
Shënim zyrtar		3		
Kërcënim i sigurisë (neni 144)			3	
Kërcënim i sigurisë (neni 144 alinea 4)				2
Kërcënime verbale apo online			9	5
Shkelje e të drejtës autoriale apo të drejtave të përafërta				1

Ministria e Brendshme në përgjigjen e saj ka përfshirë edhe statistikën për vitin 2018, edhe pse nuk ishte theksuar në kërkesë. Vërehet se në vitin 2018 dhe në vitin 2019 nuk ka kallëzime penale të dorëzuara, ndërsa në vitin 2020 dhe 2021, janë dorëzuar nga 3 kallëzime penale deri tek prokuroria kompetente publike. Për rastet e tjera të regjistruara janë lëshuar gjithsej 13 paralajmërime, pastaj janë dorëzuar 7 njoftime deri tek PTHP dhe gjithsej 7 kallëzime kundërvajtëse.

Statistika e MPB-së tregon se në vitin 2020 janë regjistruar gjithsej 9 kërcënime verbale dhe online prej të cilëve 3 me denoncim për veprë penale Kërcënim të sigurisë nga neni 144 i Kodit Penal. Për vitin 2021 janë regjistruar 5 kërcënime verbale dhe online prej të cilëve 2 për veprë penale Kërcënim të sigurisë nga neni 144, alinea 4 nga Kodi Penal.

Vërehet një progres në drejtim të denoncimit të kërcënimeve online nga ana e gazetarëve dhe rritje të numrit të rasteve të proceduara të kallëzimeve penale nga ana e MPB-së deri tek prokuroritë kompetente publike për vepra penale në të cilat si të dëmtuar apo viktimë paraqiten gazetarët.

Por nga ana tjetër, prej vitit 2019 e deri në vitin 2021 vërehet ulje e numrit të denoncimeve. Kjo analizë nuk mund të japë përgjigje në pyetjen se përse është ulur numri i denoncimeve, se a ka rritje të mosbesimit ndaj institucioneve, a bëhet fjalë për numër më të vogël të sulmeve apo ndoshta arsyeja është aktiviteti i shtuar i veprimtari të organeve shtetërore.

Në përgjigjen e MPB theksohet se më 29.12.2017 është nënshkruar një Memorandum për bashkëpunim për ndërmarrje të aktiviteteve për përmirësimin e gjendjeve mes MPB-së dhe SHGM-së, pas çka ndihmës ministri për marrëdhënie me publikun është emëruar edhe si person i angazhuar për reagim urgjent për çfarëdo problemi që e kanë gazetarët.

MPB nuk jep përgjigje në pyetjen nëse ka punonjës policie apo inspektorë të trajnuar që do të jenë kompetent për veprim pas denoncimeve nga gazetarët dhe punonjësit mediatik, por thekson se “MPB i përpunon, si rastet që regjistrohen në stacione policore ashtu edhe ato të dorëzuara deri tek Sektori për kriminalitet kompjuterik dhe forenzikë digjitale, që mund të denoncohen edhe sipas detyrës zyrtare , ndërsa paraprakisht ka mundur të vepohet vetëm nëse ishin denoncuar në stacion policor”.

Tabela 2: Përgjigje nga PTHP Shkup pas kërkesës për qasje deri tek informatat me karakter publik

Viti	Nuk është theksuar viti
Numri i kallëzimeve penale	5
Numri i procedurave në prokurori	8
Numri i procedurave penale	2
Gazetarë të dëmtuar pas denoncimit	8
Numri i të dëmtuarve nga gjinia femërore	6
Numri i të dëmtuarve nga gjinia mashkullore	2
Kërcënim i sigurisë (neni 144 alinea 4 nga KP)	2
Pjesëmarrje në turmë nga neni 285, alinea 2.	1
Verdikt	2
Të plotfuqishme	1
Burg	2

Për nevojat e kësaj analize ishin dorëzuar kërkesa për qasje deri tek informacionet me karakter publik deri tek 22 prokurori themelore në Maqedoninë e Veriut. Përgjigje dorëzuan vetëm 16, në mesin e tyre edhe Prokuroria Themelore Publike e Shkupit.

Të gjitha përgjigjet e prokurorive themelore, me përjashtim të PTHP Shkup, janë identike dhe do të prezantohen së bashku. Përgjigja e PTHP Shkup që dallohet nga të gjitha përgjigjet e prokurorive themelore do të analizohet në mënyrë të veçantë.

Në përgjigjet e 15 prokurorive publike theksohet se në periudhën e viteve 2019, 2020 dhe prej 1 janarit të vitit 2021 deri më 30 tetor 2021, nuk janë dorëzuar kallëzime

penale për sulm ndaj gazetarëve apo punonjësve mediatik, nuk ka denoncime për vepra penale Vrasje sipas nenit 124, Lëndim trupor nga neni 130, Lëndim i rëndë trupor nga neni 131, Detyrim nga neni 139, Privim i paligjshëm nga liria sipas nenit 140, Kërcënim i sigurisë sipas nenit 144 apo për ndonjë vepër tjetër penale të paraparë në Kodin penal ku si viktimë/i dëmtuar paraqitet ndonjë gazetar apo punonjës mediatik, nuk janë dorëzuar kallëzime penale nga Sektori për kriminalitet kompjuterik dhe forenzikë digjitale pranë MPB-së për kërcënime të bëra nëpërmjet sistemit informatik ndaj gazetarëve apo punonjësve mediatik sipas nenit 144, alinea 4 nga KP – Kërcënim i sigurisë; nuk ka denoncime ku viktima apo të dëmtuarit janë gazetarë apo punonjës mediatik - femra ; nuk ekziston ndonjë denoncim i proceduar deri tek gjykata kompetente; nuk ekziston raport i veçantë apo prokurorë që janë të trajnuar/ specializuar që të veprojnë pas kallëzimeve penale për vepra penale të kryera ndaj gazetarëve apo punonjësve mediatik.

Në përgjigjen e PTHP Shkup nuk janë dhënë informata me vite të ndara siç ishte kërkuar. Sipas informacioneve të dorëzuara, në periudhën e viteve 2019, 2020 dhe prej 1 janar e deri 30 tetor të vitit 2021, ishin dorëzuar 5 kallëzime penale. Duke marrë parasysh se ishin dëmtuar 8 gazetarë/punonjës mediatik, janë zhvilluar 8 procedura ndërsa janë dorëzuar vetëm 2 aktakuza deri tek Gjykata Themelore Penale. Prej tetë aktakuzave në 3 raste po ndërmerren procedura parahetimore, ndërsa në 2 raste me rezolutë është vërtetuar se nuk ka hapësirë për intervenim të prokurorëve⁹, në një procedurë është konstatuar se për mesazhet e dërguara nëpërmjet rrjetit social Telegram nuk është ngritur akuzë pasi që të njëjtat janë vetëm ofendim dhe shpifje që janë dekriminalizuar, dhe të dëmtuarit mund të kërkojnë mbrojtje në një procedurë civile, dhe për 2 procedura janë dorëzuar aktakuza.

PTHP Shkup e plotëson listën e veprave penale që mund të ndodhin ndaj një gazetari/ punonjësi mediatik me informatë se është dorëzuar akuzë kundër 7 personave për veprën penale Pjesëmarrje në turmë nga neni 285, alinea 2 e Kodit Penal, ngjarje që lidhet me protestën për rastin “Monstra” në të cilën kameramani i televizionit “Sonce” me inicialet B.S, është lënduar me lëndime të rënda trupore. Autorët janë dënuar me burg në shkallën e parë, dhe vendimi nuk është ende i plotfuqishëm.

Prej 8 gazetarëve dhe punonjësve mediatik të dëmtuar, 6 janë të gjinisë femërore ndërsa 2 të gjinisë mashkullore.

PTHP Shkup nuk jep përgjigje në pyetjen nëse ka prokurorë publik të trajnuar për veprim gjatë kallëzimeve ku të dëmtuarit/viktimat janë gazetarë apo punonjës mediatik.

9 Kur prokurori publik do të konkludojë se nuk ekzistojnë prova të cilat çojnë në dyshimin se është kryer vepër penale që përndiqen në bazë të detyrës zyrtare, me rezolutë konstatohet se nuk ka hapësirë për veprim të prokurorëve në këtë rast.

Tabela 3: Përgjigje nga Gjykata Themelore Penale Shkup pas kërkesës për qasje te informatat me karakter publik

Viti	2019	2020	2021
Numri i procedurave penale	0	1	0
Gazetarë të dëmtuar	0	2	0
Numri i gazetarëve të dëmtuar nga gjinia femërore	0	2	0
Numri i gazetarëve të dëmtuar nga gjinia mashkullore	0	0	0
Kërcënim i sigurisë (neni 144)	0	1	0
Verdikt	0	1	0
Të plotfuqishme	0	1	0
Sanksion penal	0	1	0

Për nevojat e kësaj analize janë dërguar kërkesa për qasje deri tek informata me karakter publik në 26 gjykatat themelore në Maqedoninë e Veriut. Përgjigje kanë dorëzuar 24 gjykata themelore mes të cilëve edhe Gjykata Penale në Shkup.

Është me rëndësi të theksohet se prej 24 gjykatave themelore që u janë përgjigjur kërkesave, vetëm 5 prej tyre kanë nënvizuar se kontrollimet i kanë kryer përmes Sistrmit të autorizuar informativ për menaxhim me lëndët në gjykata, derisa gjykatat tjera nuk kanë nënvizuar se në çfarë forme i kanë siguruar informacionet.

Gjykata e Manastirit është edhe më precize duke theksuar se “të dhëna për profesionin apo atë me çka merren personat e dëmtuar sipas regjistrimit penal nuk shënohen në sistemin AKMIS, kështu që nuk është e mundur që këto të dhëna të filtrohen nëse ekzistojnë, respektivisht, nuk kemi mundësi që të t’ua japim këto të dhëna”.

Në përgjigjet e 23 gjykatave themelore theksohet se në periudhën e viteve 2019, 2020 dhe prej 1 janarit të vitit 2021 deri më 30 tetor 2021, nuk janë dorëzuar kallëzime penale për sulm ndaj gazetarëve apo punonjësve mediatik, nuk ka denoncime për vepra penale Vrasje sipas nenit 124, Lëndim trupor nga neni 130, Lëndim i rëndë trupor nga neni 131, Detyrim nga neni 139, Privim i paligjshëm nga liria sipas nenit 140, Kërcënim i sigurisë sipas nenit 144 apo për ndonjë vepër tjetër penale të paraparë në Kodin penal ku si viktimë/i dëmtuar paraqitet ndonjë gazetar apo punonjës mediatik, nuk janë dorëzuar kallëzime penale për kërcënime të bëra nëpërmjet sistemit informatik ndaj gazetarëve apo punonjësve mediatik sipas nenit 144, alinea 4 nga KP – Kërcënim i sigurisë; nuk ka denoncime ku viktima apo të dëmtuarit janë gazetarë apo punonjës mediatik - femra ; nuk ekziston ndonjë denoncim i proceduar deri tek gjykata kompetente ; nuk ekziston repart i veçantë apo gjykatës që janë të trajnuar/

specializuar që të veprojnë pas kallëzimeve penale për vepra penale të kryera ndaj gazetarëve apo punonjësve mediatik.

Në përgjigjen e Gjykatës Themelore të Shkupit theksohet se në periudhën e viteve 2019, 2020 dhe prej 1 janarit e deri më 30 tetor të vitit 2021, janë regjistruar dy procedura penale që janë përfunduar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor e në të cilat si të dëmtuar/viktima paraqiten gazetarë apo punonjës mediatik dhe kanë qenë lëndë me interes publik dhe të ndjekura nga mediat.

Në lëndën K.br.212/20 i akuzuari E.J është dënuar me vendim të plotfuqishëm me burg për veprën penale Kërcënim të sigurisë sipas nenit 144, alinea 4 nga Kodi Penal, ku si të dëmtuara paraqiten dy gazetarë. Në lëndën K.br.631/18¹⁰ i akuzuari është dënuar me vendim të plotfuqishëm me burg për veprën penale Dhunë nga neni 383 alinea 3 në lidhje me paragrafin 1 nga Kodi Penal, ku si palë e dëmtuar paraqiten një gazetar dhe një kameraman.

Prej gjithsej 4 gazetarë/punonjës mediatik të dëmtuar, 2 janë të gjinisë femërore ndërsa 2 të gjinisë mashkullore.

Në pyetjen se a ka gjykatës të trajnuar që janë kompetent për veprim në raste kur të dëmtuarit/viktimat janë gazetarë apo punonjës mediatik, Gjykata Themelore në Shkup përgjigjet, “në Gjykatën Themelore Penale në Shkup, e njëherazi në asnjë gjykatë të shkallës së parë në shtet, ligjvënësi nuk ka paraparë që të ketë reparte të specializuara apo gjykatës që do të veprojnë vetëm në lëndë për vepra penale të kryera ndaj gazetarëve apo punonjësve mediatik”.

Gjatë zbatimit të analizës së të dhënave të marra nëpërmjet kërkesës për qasje deri tek informatat me karrkater publik, si pikënisje është marrë evidenca e SHGM-së¹¹, për rastet e shkeljes së të drejtave të gazetarëve deri në vitin 2021, pasi për momentin ky është burimi më relevant i të dhënave për sulmet ndaj gazetarëve/punonjësve mediatik, duke marrë parasysh se i ka evidentuar të gjitha sulmet për të cilat e kanë informuar gazetarët, përfshirë edhe ato për të cilat nuk kanë dorëzuar kallëzim formal në MPB apo PTHP.

Vërehet se ka dallime mes evidencës së SHGM-së dhe evidencës së MPB-së, PTHP-së dhe gjykatave të tjera, si në aspektin kuantitativ, ashtu edhe në aspektin territorial.

Dallimi kuantitativ ka të bëjë me mungesën e një sistemi kualitativ të evidentimit të të dhënave nga të gjitha organet. Dallimi territorial nuk mund të shpjegohet. Për nevojat e kësaj analize janë kërkuar të dhëna për gjithë territorin e RMV-së. Nga të

10 Gjykata Themelore Penale Shkup, qasur më 8 dhjetor 2021, <https://bit.ly/3pp2l53>

11 Raste të shkeljes së të drejtave të gazetarëve 2021, qasur më 8 dhjetor, <https://znm.org.mk/povreda-na-novinari/>

dhënat që kemi marrë, sikur të mos ketë pasur sulme në qytetet e banimet e tjera përveç në kryeqytet, Shkup. Për dallim prej përgjigjeve të organeve kompetente, sipas evidencës së SHGM-së në periudhën që përfshin analiza, gjatë vitit 2019, 2020 dhe 2021, ka pasur sulme edhe në Kumanovë, Tetovë dhe Kërçovë.

Mbledhja, analiza dhe zbatimi i këtyre të dhënave na sjellë konstatimin se gazetarët për sulmet që ju bëhen fillimisht e informojnë opinionin nëpërmjet mediave të tyre, dhe nëpërmjet profileve në rrjetet sociale, ndërsa më pas lajmi përcillet nga të gjitha mediat. Hapi i dytë sipas analizës është denoncimi në SHGM, ndërsa hapi i tretë është denoncimi në MPB/stacion policor apo prokurori. Kjo pa dyshim tregon nivelin e ulët të besimit tek institucionet.

3 KORNIZA LIGJORE PËR SIGURI TË GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK

Republika e Maqedonisë së Veriut si shtet që pretendon të jetë pjesë e Bashkimit Evropian dhe po pret datë për nisjen e negociatave për anëtarësim, vazhdimisht është në proces harmonizimi të ligjeve vendore me legjislativin e BE-së. Qeveria e RMV-së vazhdimisht inicion harmonizim të legjislativit vendor me atë të BE-së që nënkupton edhe pranim të normave që i përmbajnë rregullativat e BE-së dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës.

Për sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve mediatik kyç është rekomandimi i Këshillit të Evropës CM/Rec (2016) 4 i Komitetit të ministrave¹² deri tek vendet – anëtare për mbrojtje të gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve të tjerë mediatik sipas të cilit qeveritë e shteteve nënshkruese duhet në mënyrë eksplicite të pranojnë se dhuna ndaj gazetarëve është kërcënim direkt i demokracisë.

Prandaj nevojitet vullnet politik që të krijohet dhe sigurohet një hapësirë për liri të shprehjes që është e garantuar me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Qeveria duhet të dërgojë mesazhe pozitive për të thënë që liria e shprehjes është jetike për demokracinë. Shtetet obligohen që të ofrojnë mbrojtje urgjente për gazetarët dhe punonjësit e tjerë mediatik edhe atë nëpërmjet parandalimit, mbrojtjes, ndjekjes penale, ngritjes së vetëdijes, si dhe implementimit të praktikave më të mira të shteteve anëtare në Këshillin e Evropës dhe legjislativin e tyre. Shtetet duhet të kontrollojnë nëse posedojnë kornizë të qartë ligjore me të cilën mbrohet e drejta për jetë, liri të shprehjes dhe të drejtat përcjellëse, dhe nëse të njëjtat në praktikë janë efikase. Nëse nuk janë, ligjet duhet të reformohen në mënyrë që të sigurohet implementimi i tyre.

¹² Recommendation CM/Rec (2016)4, Committee of Ministers to member States on the protection of journalism and safety of journalist and other media actors, 13 April 2016

Dokumentet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Maqedonia e Veriut, që janë relevante për sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve të tjerë mediatik, që përfshinë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mes të cilëve edhe sigurinë e gazetarëve, direktivat dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës, pastaj analizat e bëra në fushën e përmirësimit të sigurisë së gazetarëve, mes të cilëve Përmirësimi i sigurisë së Gazetarëve – nëpërmjet ndryshimeve në Kodin Penal – Analizë e standardeve ndërkombëtare dhe rregullativës vendore¹³ dhe Analiza e rekomandimeve për ndryshime në Kodin Penal të Maqedonisë së Veriut për mbrojtje më të madhe të ekipeve gazetareske gjatë ushtrimit të detyrave profesionale¹⁴, si dhe analizat e legjislativit vendor, janë dëshmi e qartë për nevojën e qasjes ndaj ndryshimeve në legjislativ që do të ndikonin në parandalim dhe mbrojtje nga sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve të tjerë mediatik.

Duke respektuar direktivat dhe rekomandimet, Qeveria e RMV-së në korrik të vitit 2021, përpunoi një Propozim ligj për ndryshim dhe plotësim të Kodit Penal në të cilin thuhet se “Këto ndryshime dhe plotësime në Kodin Penal përfshijnë intervenime në disa fusha ku u imponua nevoja për intervenime urgjente edhe atë për ; implementim të Konventës së Stambollit, intervenim tek veprat penale që lidhen me sigurinë e gazetarëve, ndryshim në dispozita të caktuara nga Kodi Penal (në sferën e konfiskimit dhe torturës) si rezultat i verdikteve të sjella nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut me të cilat vërtetohet shkelje e dispozitave të Konventës...¹⁵”.

Gjatë përgatitjes së këtij propozim ligji, përpos anëtarëve të grupit të punës që ishte formuar nga ministri i drejtësisë, edhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë ka marrë pjesë me propozime që lidhen me sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

